



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljenoi/Prilato Received/Delivery	30 - 11 - 8	viti god year
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr. Prot. Bi. Prot. Prot. No:	Shtojca Prilog Appendix
SKPM/SHK	7312/2018	Sasia Kolicina Quantity 111



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 324 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Deçanit, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Deçanit.
2. Obligohet Kryetari i Komunës së Deçanit për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Deçanit është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Deçanit;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Deçanit dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pr: marr / Dorëzuar Emnenor/Pro data Received/Delivery		30.11.2018 viti god year	
Organ./Rjesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr. Prot: Br. Prot: Prot. No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMShCK	7312/2018		1111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

KOMUNËN E DEÇANIT PËR VITIN 2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Komunën e Deçanit.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	5
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	6
Procedurat Disiplinore.....	6
Procedurat e Ankesave.....	7
Procedurat e Vlerësimit.....	7
Procedurat e Pushimeve.....	8
Procedurat e Transferimit.....	8
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	9
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	9
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	10
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	10
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	10
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	10
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	10
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	11

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërliken me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË KOMUNËN E DEÇANIT

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Komunën e Deçanit për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Komuna e Deçanit, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Komunën e Deçanit me datë 07.05.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Rregulloren për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbyesit Civil në Administratën e Komunës së Deçanit me numër protokolli 5278 e datës 15.11.2012;
- Konkursin për pozitën “Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët”;
- Vendimin me numër protokolli 33090 të datës 26.10.2016 për themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimin e datës 08.02.2017 për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimin me Nr. 2286 e datës 01.02.2017 për ndërrimin e vendit të punës;
- Aktvendimin me Nr. 08 të datës 04.01.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të vdekjes së nëpunësit civil;
- Vendimin e datës 25.07.2017 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për vendosjen e ankesës së datës 14.07.2017 dhe Ankesën e datës 14.07.2017 me Nr. 20129;
- Aktvendimin e datës 27.10.2017 dhe 18.12.2017 për autorizimin nga Kryetari i Komunës për Udhëheqësin e Personelit;
- Aktvendimi me Nr. 15818 i datës 02.06.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit;
- Planin vjetor të trajnimit datë 10.02.2017;
- Vendimin e datës 04.09.2017 për pushim pa pagesë gjatë fushatës zgjedhore;
- Planin e Personelit;
- Konkursin e datës 26.04.2017, 16.05.2017 dhe 14.07.2017 për kryerjen e punëve për shërbime të veçanta dhe Marrëveshjet për shërbime të veçanta;
- Kërkesën për vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil i datës 06.12.2017;
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën “Auditor i Brendshëm”;
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën “Zyrtar për tatim në pronë”;
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën “Zyrtar i Lartë për Menaxhim Financiar dhe Kontroll”;
- Listën e pagave për muajin dhjetor 2017;
- Lista e ardhje dalje e muajit shkurt 2018;

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, e vlerëson bashkëpunimin e treguar, përgatitjen e dokumenteve dhe informatat e ofruara nga Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Deçanit gjatë realizimit të vizitës me datë 07.05.2018.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Komunën e Deçanit më datë 07.05.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Shërbyesit Civil në Administratën e Komunës së Deçanit me numër protokolli 5278 e datës 15.11.2012. Në këtë institucion janë të punësuar 136 nëpunës civilë, ndërsa 3 pozita janë të lira.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se dosjet e personelit, përveç në disa dosje që nuk ka formularë të vlerësimit pasi që nuk janë vlerësuar nëpunësit civilë, të gjitha dosjet janë të kompletuara dhe të ruajtura në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të nenit 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Po ashtu, janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civilë, ndërsa si kopje janë marrë tri (3) dosje atë për pozitën “Auditor i Brendshëm”, “Zyrtar i Lartë për Menaxhim Financiar dhe Kontroll” dhe “Zyrtar për Tatim në Pronë”.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion nuk ka pasur asnjë pozitë me ushtrues detyre.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit ka përgatitur planin e personelit dhe gjatë vitit 2017 ka zhvilluar tetë (8) procedurë të rekrutimit/avancimit dhe kemi shqyrtuar të gjithë procedurën ndërsa si mostër është marrë dëshmi nga procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Arsim të Mesëm të Ulët” dhe “Zyrtar për Depo”. Po ashtu, në këtë institucion janë lidhur tridhjetë (31) kontratë me marrëveshje për shërbime të veçanta të cilat janë zhvilluar me procedura të thjeshtësuara të rekrutimit, nuk janë lidhur për pozitë të shërbimit civil dhe nuk ka pasur tejkalim të afateve të angazhimit. Lidhur me procedurat e rekrutimit kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar që Komuna e Deçanit me datë 06.04.2017 ka shpallur konkursin për trembëdhjetë (13) pozita të drejtorëve të shkollave, por nuk ka bërë njoftimin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vëzhguar këtë pozitë pasi që është pozitë e nivelit drejtues në shërbimin civil ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 3 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues dhe është pozitë e shërbimit civil.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Deçanit që ti eliminoj shkeljet dhe me rastin e publikimit të konkurseve për drejtorë dhe zëvendës drejtor të shkollave dhe institucioneve edukativo- arsimore të njoftoj Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vëzhguar këto pozitë pasi që është pozitë e nivelit drejtues në shërbimin civil, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 6 dhe 19 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dispozitave të Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Mbikëqyrjes së Përzgjedhjes së Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues dhe të Nivelit Drejtues.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit në bazë të Vendimit me numër protokolli 33090 të datës 26.10.2016 ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të vlerësimeve në këtë institucion nuk është zhvilluar asnjë procedurë disiplinore ndaj nëpunësit civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit në bazë të Vendimit të datës 08.02.2017 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 82 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në bazë të vlerësimeve në këtë komisioni gjatë vitit 2017 janë parashtruar tri (3) ankesa është vendosur edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (A/02/317/2017) ndërsa kemi shqyrtuar Vendimin e datës 25.07.2017 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për vendosjen e ankesës me Nr. 20129 së datës 14.07.2017, kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit e datës 25.07.2017 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për vendosjen e ankesës me Nr. 20129 së datës 14.07.2017, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është shpallur jo kompetent për vendosjen e ankesës me të cilën është kundërshtuar procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i SHMU "Lan Selimi". Kolegji konstaton që pozitat e drejtorëve të shkollave janë pozita të nëpunësve civil të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në bazë të nenit 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave është kompetent për të shqyrtuar ankesa lidhur me procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të shkollave.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Deçanit që në bazë të kompetencave të tij ligjore sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave është kompetent për të shqyrtuar ankesat lidhur me procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të shkollave.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit, nuk ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil pasi që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sportit dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural nuk kanë bërë vlerësimin e rezultateve në punës për nëpunësit civilë për vitin 2017, (15 nëpunës civil). Po ashtu, për gjashtë (6) nëpunës civilë për vitin 2017 është kryer vlerësimi i periudhës provuese. Lidhur me këtë fushë kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar që për 15 nëpunës civil të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sportit dhe Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural nuk kanë bërë vlerësimin e rezultateve në punës për nëpunësit civil për vitin 2017 edhe pse Zyra e Personelit e Komunës së Deçanit ka njoftuar drejtorit që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të kryhet deri më datë 31.12.2017, në këtë rast Kolegji konstaton që në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve në punë është shkelje e detyrave të punës pasi që për të gjithë nëpunësit civil duhet të bëhet vlerësimi i rezultateve në punë dhe me rastin e mos vlerësimit të gjithë nëpunësve Komuna e Deçanit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e nenit 3 paragrafit 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Deçanit dhe Udhëheqësit e drejtpërdrejtë të nëpunësve civil, që të ndërmarrin veprimet ligjore për eliminimin e shkeljeve pasi që për të gjithë nëpunësit civil duhet të bëhet vlerësimi i punës nga udhëheqësit e drejtpërdrejtë të tyre deri më datë 31 dhjetor të vitit për të cilin vlerësohen ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për gjashtë (6) nëpunës civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese dhe në bazë të dosjeve kemi marr një mostër atë për pozitën “Zyrtar i Lartë për Menaxhim Financiar dhe Kontroll” dhe kemi konstatuar se kjo pozitë është rekrutuar në vitin 2017 dhe kandidatit të përzgjedhur Akt Emërimi ju është lëshuar më datë 05.01.2017, ndërsa formulari për vlerësimin e punës provues i është lëshuar më datë 05.01.2018 me çka nënkuptohet se vlerësimi i periudhës provues nuk i është bërë 40 ditë para përfundimit të periudhës provuese ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Deçanit, që të ndërmerr masat që në të ardhmen për të gjitha vlerësimet e periudhës provuese të bëhen në pajtim me afatet dhe hapat e përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit, evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, një nëpunës ka realizuar pushimin pa pagesë, nuk ka asnjë nëpunës që ka realizuar pushimin lehonisë dhe për këtë nuk kemi konstatuar të gjetur, pasi që janë zhvilluar procedura në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit, gjatë vitit 2017, ka pasur një transferimi të përhershëm i cili ka qenë i brendshëm dhe kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 2286 të datës 01.02.2017 për ndërrimin e vendit të punës të zyrtarit të drejtësisë për buxhet dhe financa nga pozita “Zyrtar i të hyrave” në pozitën “Zyrtar për tatim në Pronë”, ka konstatuar se edhe pse transferimi është bërë në të njëjtën drejtori në vendim nuk është specifikuar që është transferim pasi që as në preambulë as në arsyetim nuk ka asnjë dispozitë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse transferimi i nëpunësve civil duhet të bëhet mbi bazën e dispozitave të këtij ligji dhe kësaj rregulloreje.

REKOMANDIM 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Deçanit, që të ndërmerr masat që në të ardhmen për të gjitha transferimet e nëpunësve civil në vendim të përshkruhen saktë dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil pasi që kjo është baza për transferim të nëpunësve civil.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit, ka të punësuar 136 nëpunës civil, 133 janë shqiptar, 2 boshnjak dhe 1 serb. Prej 136 të punësuarave 30 femra dhe 106 meshkuj, ndërsa tre (3) nëpunës civil me nevoja të veçanta janë të punësuar në këtë institucion. Në bazë të vlerësimeve në këtë fushë është konstatuar kjo e gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 136 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Deçanit, 30 prej të punësuarve janë femra ndërsa 106 janë meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIM 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Deçanit, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Komunën e Deçanit, asnjë nëpunës nuk ka gëzuar të drejtës e pezullimit të dakorduar. Në bazë të vlerësimit të dosjeve një nëpunës civil ka marr pushim pa pagesë, asnjë nëpunës, nuk ka asnjë nëpunës civil të cilit i është ndërpre marrëdhënia e punës (për shkak të paaftësisë për të vepruar dhe shkarkimit), shkarkimit apo dorëheqjes. Po në bazë të vlerësimit të dosjeve është konstatuar që dy nëpunës civil i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së pensionimit të cilëve i është bërë pagesa e një page të njëhershme në pajtim me legjislacionin në fuqi, ndërsa nuk ka asnjë nëpunës civil që i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak (ushtrimit të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punësi me afat të caktuar, dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë), ndërsa një nëpunësi civil i është përfunduar marrëdhënia e punës me vdekje dhe Komuna nuk ka bërë pagesën e një page sipas ligjor dhe në këtë rast kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 08 të datës 04.01.2017 me përfundimin e marrëdhënies së punës me rastin e vdekjes së nëpunësit civil Komuna e Deçanit ka nxjerr vendim, mirëpo nga zyra e personelit jemi njoftuar që nuk është bërë kompensimi i një page të fundit për familjen e nëpunësit civil, që është shkelje e dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nënparagrafit 2.4 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIM 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Deçanit dhe Zyrën për Buxhet dhe Financa që të ndërmarr masat ligjore për eliminimin e shkeljeve pasi që duhet bëhet pagesa/ndihma për familjen në rast të vdekjes së nëpunësit civil dhe vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së nëpunësit civil në pajtim me dispozitat Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Komunën e Deçanit, nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë ndonjë funksion tjetër publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Komunën e Deçanit, nuk ka asnjë nëpunës që është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ose është dënuar me vendim të gjykatës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit respektivisht zyra e personelit, ka përgatitur planin e trajnimeve në të cilin përfshihen edhe trajnimet, por dhe të cilat trajnime janë marrë parasysh nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe nëpunësit civil kanë ndjekur trajnimet.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHTESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit, vijimin në punë e mban në formë fizike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet ndërsa përveç IT-së që gëzon shtesë asnjë nëpunës civil nuk gëzon ndonjë shtesë tjetër.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Deçanit, ka pranuar dy (2) vendime të Këshillit dhe nuk ka pasur për obligim zbatimin e tyre.

Komuna e Deçanit në vitin 2017 është monitoruar për vitin 2016 dhe janë dhënë dhjetë (10) rekomandime, ku gjashtë (6) prej tyre janë adresuar ndërsa katër (4) nuk janë adresuar.

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar shtatë (7) të gjetura dhe ka dhënë shtatë (7) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Komunës së Deçanit, që **gjetjet me rekomandimet** e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Shkëmb MANAJ

Kryetar i Kolegjit

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Deçanit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Deçanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK